

ALBDESIGN PSP SH.P.K

Raporti i Audituesit të pavarur dhe

Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	1
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	4
Pasqyra e fluksit të parasë	5
Shënime mbi pasqyrat financiare	6 - 19

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e vetëm të Shoqërisë Albdesign PSP shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albdesign PSP shpk (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuiojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose te marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



ILD 99 Audit shpk
Luan Kamberi
Partner



13 mars 2017

Albdesign PSP sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	21,318,714	5,170,827
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	75,555,290	40,305,919
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	2,082,320	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	8,124,049	-
Inventari	8	220,170	4,082,093
Shpenzime të shtyra	9	6,459,343	-
Total Aktive Afatshkurtra		113,759,886	49,558,839
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	35,841,680	4,614,659
Total aktive afatgjatë		35,841,680	4,614,659
Total Aktive		149,601,566	54,173,498
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	141,376	-
Llogari të pagueshme tregëtare	12	107,052,823	39,718,469
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	13	34,659	-
Detyrime tatimore	14	2,025,081	2,148,298
Të ardhurat e shtyra		3,333,333	-
Të tjera detyrime	15	30,080	273,200
Total Detyrime afatshkurtra		112,617,352	42,139,967
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme ndaj palëve e lidhura	16	2,985,840	3,985,840
Total Detyrime afatgjatë		2,985,840	3,985,840
Totali i detyrimeve		115,603,192	46,125,807
Kapitali themeltar			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva të tjera		7,947,691	-
Fitimi i ushtrimit		25,950,683	7,947,691
Total kapitali themeltar		33,998,374	8,047,691
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		149,601,566	54,173,498

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	200,701,223	71,155,327
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	32,464	44,061
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(156,529,758)	(56,382,097)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(131,353,347)	(55,814,938)
2) Të tjera shpenzime	21	(25,176,411)	(567,159)
Shpenzime te personelit	22	(12,204,197)	(5,295,656)
1) Paga dhe shpërblime		(10,528,958)	(4,579,318)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(1,675,239)	(716,338)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(1,426,598)	(157,026)
Shpenzime financiare	23	(3,535)	-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,713)	-
2) Shpenzime të tjera financiare		(1,822)	-
Fitimi/humbja para tatimit		30,569,599	9,364,609
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(4,618,916)	(1,416,918)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(4,618,916)	(1,416,918)
Fitimi/humbja e vitit		25,950,683	7,947,691
Te ardhura te tjera gjithperفشیرهه per vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		25,950,683	7,947,691

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	100,000			7,947,691	8,047,691
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	-	-	7,947,691	8,047,691
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015					
Fitimi / Humbja e vitit				25,950,683	25,950,683
Lëvizjet përmes kapitalit		10,000	7,937,691	(7,947,691)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	10,000	7,937,691	25,950,683	33,998,374

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 -19 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga administratori më 13 Mars 2017 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


 Erion Tafaj
 Administrator

ALBDESIGN PSP
 Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
 NIP: L518190050


 Mazars shpk
 Hartues i Pasqyre

 **MAZARS**
 Rr. Emin Dugan, Pjellë, Elbasan
 Nr. 5, 1000, Tiranë - Shqipëri
 Phone: +36 42 27 80 15
 Email: info@mazars.al
 www.mazars.al

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	25,950,683	7,947,691
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	7,460	5,965
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	544,519	1,416,918
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,426,598	157,026
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(51,915,082)	(40,305,919)
Rënie/(rritje) në inventarë	3,861,923	(4,082,093)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	69,761,410	40,470,481
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	30,080	252,568
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	49,667,591	5,862,637
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(32,653,619)	(4,771,685)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(32,653,619)	(4,771,685)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit themeltar	-	100,000
Hua të arkëtuara	141,376	3,985,840
Pagesa e huave	(999,692)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(858,316)	4,085,840
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	16,155,656	5,176,792
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	5,170,827	
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(7,769)	(5,965)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	21,318,714	5,170,827
4		

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

“Albdesign PSP” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë QKR me datë 19/06/2015 me NIPT L51819005Q në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek (njëqindmijë) i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 lekë, me aksioner të vetëm z. Elvis Sula.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje shtypshkrime të ndryshme, punime grafike dhe dizenjime. Viti 2015 është viti i parë i aktivitetit të kompanisë. Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja Mezeze, Rruga "Çerçiz Topulli", Nr.17, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar Tiranë.

Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L51819005Q.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 36 punonjës.

1. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.1. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.4.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.4.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79
GBP/LEK	157.56	186.59

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën fillestare.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm.

4. MJETE MONETARE

Gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	18,197,329	5,167,361
Llogari rrjedhëse	18,197,329	5,167,361
Mjete monetare në arkë	3,121,385	3,466
	21,318,714	5,170,827

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Klientë vendas	75,555,290	40,305,919
	75,555,290	40,305,919

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA PALËT E LIDHURA

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Te arkëtueshme Tregtare nga MAG	82,320	-
Te tjera te arkëtueshem nga MAG	2,000,000	-
	2,082,320	-

7. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATSHKURTRA

Të tjera llogari të arkëtueshme afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime doganore	82,058	-
Te tjera kërkesa per arketim	658,334	-
TVSH Kreditore	7,056,657	-
Garanci për tendera	327,000	-
	8,124,049	-

8. INVENTARI

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 ,paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Lëndë e parë	45,764	4,082,093
Mallra për rishitje	174,406	-
	220,170	4,082,093

9. SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhejtor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Shpenzime të shtyra	45,710	-
Parapagime për furnitorët	6,413,633	-
	6,459,343	-

10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Përshkrimi	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilje dhe orendi	Kompjuter	Të tjera	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2014						-
Shtesa	325,442	4,309,005		99,071	38,167	4,771,685
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	325,442	4,309,005	-	99,071	38,167	4,771,685
Shtesa	29,639,690	1,295,880	584,182	782,376	351,491	32,653,619
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	29,965,132	5,604,885	584,182	881,447	389,658	37,425,304
Zhvlërësimi i akumuluar						
Amortizimi i vitit	10,848	143,634		-	2,544	157,026
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	10,848	143,634	-	-	2,544	157,026
Amortizimi i vitit	152,079	1,049,054	121,178	66,608	37,679	1,426,598
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	162,927	1,192,688	121,178	66,608	40,223	1,583,624
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	314,594	4,165,371	-	99,071	35,623	4,614,659
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	29,802,205	4,412,197	463,004	814,839	349,435	35,841,680

11. HUA AFATSHKURTRA

Hua-të afatashkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhejtor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Overdraft Karta Kreditit Raiffeisen	141,376	-
	141,376	-

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhejtor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitorë vendas	106,770,759	39,213,677
Furnitorë te huaj	282,064	504,792
	107,052,823	39,718,469

13. TË PAGUESHME PËR SHPENZIME TË KONSTATUARA

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Furnitore per fatura te pa mberitura	34,659	-
	34,659	-

14. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	250,597	195,745
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	19,279	5,200
Tatim në Burim	1,210,686	2,065
Tatim fitimi	544,519	1,416,918
TVSH për t'u paguar	-	528,370
	2,025,081	2,148,298

15. DETYRIMET TE TJERA

Detyrimet e tjera të cilat paraqesin detyrimet ndaj pononjësve dhe të tjera detyrime, më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 ,paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Detyrime ndaj personelit	30,080	244,198
Dietat e punonjësve	-	8,370
Të tjera detyrime	-	20,632
	30,080	273,200

16. LLOGARI TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqesin financimet e ortakut, dhe më 31 Dhjetor 2016, dhe 31 dhjetor 2015,paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Finacim Elvis Sula	2,985,840	3,985,840
	2,985,840	3,985,840

17. KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 100,000 Leke.

18. TË ARDHURA

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e Produkteve të gatshëm	164,495,547	58,244,958
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	6,399,138	1,077,228
Të ardhura nga shitja e mallrave	29,369,057	11,833,141
Të ardhura nga shitja e materialeve	437,481	-
	200,701,223	71,155,327

Tabela më poshtë përfaqëson rakordimin e të ardhurave me deklaratimet mujore të TVSH-se.

	Për vitin e mbyllur më Dhjetor 2016
Rakordimi ndërmjet të Ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruara në FDP	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	204,034,556
Parapagime	(3,333,333)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	200,701,223
Shitje produkte të gatshme	164,495,547
Shitje mallrash e materialeve	29,806,538
Shitje shërbime	6,399,138
Të ardhura të deklaruara në Pash që janë deklaruar shitje në FDP	200,701,223
Fitim nga këmbimet valutore	87,214
Të ardhura nga interesat	724
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	200,789,161

19. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera jo-kryesore dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitime nga këmbimet valutore	86,905	55,601
Humbje nga këmbimet valutore	(54,441)	(11,540)
	32,464	44,061

20. MATERIALE TË PARA DHE TË KONSUMUESHME

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të materialeve të para të konsumueshme dhe të shërbimeve:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Kosto e lëndëve të para e materialeve	76,819,852	34,951,717
Kosto e Mallrave	24,711,751	11,387,680
Qera Trualli dhe ndërtese	12,245,179	-
Qera infrastrukturë prodhimi	11,435,912	7,027,674
Nënkontraktorë	5,159,284	2,343,999
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	834,769	103,868
Qera të tjera	94,000	-
Shërbime e shpenzime të tjera	52,600	-
	131,353,347	55,814,938

21. SHPENZIME TË TJERA

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të shpenzimeve të tjera:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Konsulencë për shitje dhe asistencë teknike	18,391,680	
Shpenzime udhëtimi e dieta	1,157,179	91,740
Shërbime postare	842,430	4,461
Shpenzime për kontrolle teknike e certifikime	800,076	277,212
Shpenzime administrative noteriale	777,113	3,700
Shpenzime për pjesmerja në tender	764,537	
Shpenzime për kërkime	556,866	
Shërbim Auditimi & Konsulencë e ekonomike	509,608	-
Të tjera	352,797	13,765
Komisione bankare	207,969	43,579
Taksa Vendore	197,000	11,820
Shpenzime trajnimi & rekrutimi	191,385	
Prime të sigurimit	175,716	15,300
Kanceleri	162,408	105,582
Shpenzime për mirëmbajtje programe kompjuterike	59,647	
Leje Mjedisi	30,000	
	25,176,411	567,159

22. SHPENZIME PERSONELI

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për paga dhe shpërblime	10,528,958	4,579,318
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,675,239	716,338
	12,204,197	5,295,656

23. SHPENZIME FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	(2,437)	-
Të ardhura nga interesat	724	-
Humbje nga këmbimet valutore nga huatë	(2,130)	-
Fitime nga këmbimet valutore nga huatë	308	-
	(3,535)	-

24. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin është llogaritur si me poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	30,569,599	9,364,609
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	223,172	81,509
Tatim në burim i paguar për furnitorin	23,879	
Produkte skarco	26,460	
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	172,833	81,509
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	30,792,771	9,446,118
Tatim fitimi @15%	4,618,916	1,416,918
Fitimi i vitit	25,950,683	7,947,691

25. PALËT E LIDHURA

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, si njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar detajohet si me poshtë:

Bilanci kontabël	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Të arketueshme nga palët e lidhura		
Mag Utiliteies	2,082,320	-
	2,082,320	-
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
Orkaku Elvis Sulo	2,985,840	3,985,840
	2,985,840	3,985,840
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
MAG Utilities	68,600	-
	68,600	-

26. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, Konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

27. NGJARJE PAS BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.